



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës

KONTRATË PËR SHERBIME

KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e perfaqëson Menaxheri i Prokurimit z. Gëzim Ademaj , Rruga “Fadil Ferati” në një rën anë;

dhe

“NATONII” SHPK me NRB 81014978, nga Gurrakoci, Komuna e Istogut, të cilën e perfaqëson z. Naton Kabashi në cilësinë e drejtorit të ndermarrjes nga ana tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS

RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NE SHKOLLËN FILLORE “BAJRAM CURRI” ISTOG

Nr. I prokurimit	633 – 020 -4838 -5-3-6 C 397
I brendshëm	633-020 / 070-236 C397

Neni 1 Lënda

1.1 RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NE SHKOLLËN FILLORE “BAJRAM CURRI” ISTOG

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 04.11.2020 dhe përfundon me 04.12.2020

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30. ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes se sherbimeve do te jetë RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NE SHKOLLËN FILLORE “BAJRAM CURRI” ISTOG

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe

ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 3.808,70 €;
Me shkronja "Tremijë/Tetëçind/Tetë/ eroe70/100"**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Autoriteti Kontraktues do ta paguaj shumën totale te pagesës pas kryerjes së shërbimeve

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i puneve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni nuk aplikohet

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryejë njërin ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënues nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrim.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Themelore - Departamenti per Çështje Ekonomike.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe dhe Serbisht në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për: Autoritetin Kontraktues
Komuna e Istogut**

**Për Kontraktorin:
"NATONII" Shpk**

Emri:	<i>Gëzim Ademaj</i>	Emri:	<i>Naton Kabashi</i>
Pozita:	<i>U.D. I Menaxher-it të Prokurimit</i>	Pozita:	<i>D r e j t o r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>05.11.2020</i>	Data:	<i>5.11.2020</i>
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Renovimi I nyjeve hidrosanitare ne shkollen Bajram Curri ne Istog

Ne çmim njesi duhet te parashihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas projektit dhe testimi i materialeve para leshuares ne pune. Sistemimi i materialeve, pastrimi i punishtes nga mbeturinat gjate dhe pas kryerjes se punimeve. Per te gjitha materialet dhe produkte ndertimore qe perdoren, paraprakisht te ofrohen certifikatat mbi kualitetin e tyre te cekura edhe ne pozicion. Materialet dhe produkte ndertimore si dhene ne pozicion nuk duhet te ndryshohen apo zevendesohen pa aprovim nga projektuesi.

Pos	Përshkrimi	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€ /Total
-----	------------	--------	-------	----------	----------

1	Mobilizimi i ndermarrjes per fillimin e punimeve.	P.S	1	5.00 €	5.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i Durëlarësve nga porcelani i klasa e parë me dim. 55x45cm te varur ne mure. Ne çmimi te llogarite, sifoni , aksesoret, pjesët lidhëse komplet dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogaria behet për cope.	copë	2	27.50 €	55.00 €
3	Demolimi i rubinetave egzistuese te duarlareseve.Furnizimi, transporti dhe montimi i Rubinetave (krojeve) mekanike për ujë te ftohtë dhe te nxehte te prodhuesit Adell ose ekuivalent me se paku 5 vite garancion. Ne çmimi te llogariten aksesoret(ek ventilat,gypat fleksibil), pjesët lidhëse komplet dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogaria behet për cope.	copë	26	17.50 €	455.00 €

4	Demolimi i rezervuarve egzistues te WC guaskave,furnizimi, transporti dhe montimi i rezervuarve te ujit te ri sipas atyre egzistues dhe kroin për pastrim. Ne çmimi te llogariten, rubineta e ujit për pastrim, EK vetilat, pjesët lidhëse komplet dhe te gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni. Llogaria behet për cope.	copë	24	24.00 €	576.00 €
5	Demolimi i rubinetave dhe sifoneve egzistuese te pisuarve .Furnizimi, transporti dhe montimi i Rubinetave (krojeve) mekanike për ujë te ftohtë te prodhuesit Adell ose ekuivalent me se paku 5 vite garancion. Ne çmimi te llogariten aksesoret(ek ventilat,gypat), pjesët lidhëse komplet dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogaria behet për cope.	copë	12	3.00 €	36.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i ujëmbledhësve montues ne dysheme me kornize inoxi. Ne çmimi te llogaritet pjesët lidhëse komplet,dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Materiali duhet te jete me standard te kualitetit TS-EN ISO 9001: 2000. Llogaria behet për cope.	copë	2	5.00 €	10.00 €
7	Thyerja e pllakave, vendosja e ekventileve per elementet shpenzuese jashtefunksioni,vendosja e kokave te reja perfundimtare dhe punet percjellese per shtangim te tyre.	copë	4	5.00 €	20.00 €
8	Furnizimi dhe montimi i dyerve të hyrjes ne toalete . Shtukot/kornizat të jenë metalike t=1,2mm të pajisura me gomë perimetrike , mentesha tri pjesësh, mekanizmi mbyllës dhe dorezë Inox; me izolimi akustik te akorduar (≥32dB). Shtuko/kornizat dhe paneli i derës me nuanca RAL: sipas atyre egzistuese. Dyertme dim.90/210cm. Dyert e hyrëse te sanitareve me mekanizmin vetëmbyllej. Te gjitha dyert dhe materialet e tyre materialet duhet te jene me standarde te kualitetit sipas ISO 9001. Llogariten ne cope.	copë	2	135.00 €	270.00 €
9	Demolimi i dyerve egzistuese te tualeteve nga pvc me dim 70x190cm,furnizimi dhe vendosja e dyerve te reja sipas atyre egzistuese,ne llogari te parashihet edhe rregullimi i shpaletave.	copë	5	135.00 €	675.00 €

10	Demolimi i ngjitsit te pllakave te cilat mungojne ne siperfaqet e mureve te tualeteve,Furnizimi dhe montimi i pllakave të qeramikës në muret e tualeteve. Pllakat e klasës se parë sipas standardit EN 1441 I,me ngjitës për pllaka q. sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C). Preferohen nuancat sipas atyre egzistuese. Llogaritet ne metër katror.	m ²	37	13.00 €	481.00 €
11	Demolimi i ngjitsit te pllakave te cilat mungojne ne siperfaqet e poshtme te tualeteve dhe koridoreve,Furnizimi dhe montimi i pllakave të qeramikës . Pllakat e klasës se parë sipas standardit EN 1441 I,me ngjitës për pllaka q. sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C). Preferohen nuancat sipas atyre egzistuese. Llogaritet ne metër katror.	m ²	84	0.80 €	67.20 €

12	Ngjyrosja e sipërfaqeve të tavanëve dhe mureve të brendshëm të toalettëve të shkollës së vjetër me ngjyrë ekologjike. Ngjyra duhet të jetë për ambiente të brendshëm e cila dallohet me ujë +10%, rezistente në fërkim të thatë. Ngjyrosje bëhet me bazë dhe në dy shtresa me ngjyrë të bardhë. Ngjyrrat duhet të jenë me veti larese-pastruese dhe punohen në akordim me standardin ISO 9001: 2000. Ngjyre e Bardhe.	m ²	360	0.80 €	288.00 €
13	Ngjyrosja e sipërfaqeve të jashtme të pjesës lindore të shkollës së re me ngjyrë yndyrore deri në lartësi 1.6m. Ngjyra duhet të jetë për ambiente të jashtme, rezistente në fërkim të thatë dhe në të lagësht. Ngjyrosje bëhet me bazë dhe në dy shtresa me ngjyrë hiri. Ngjyrrat duhet të jenë me veti larese-pastruese dhe punohen në akordim me standardin ISO 9001: 2000.	m ²	14	0.75 €	10.50 €
14	Demolimi i fasadës së shtyllave të përparshme të shkollës së re, demolimi të realizohet deri në konstruksionin BA të shtyllave, pastaj të bëhet furnizimi, montimi-mbeshjtjellja e tyre me fasadë nga pllakat Fundermax 6mm-ngjyre hiri, në pozicion të parashihen të gjitha elementet përcjellese për vendosje të pllakave në rrafsh me fasadën egzistuese Demit.	m ²	45	6.00 €	270.00 €
15	Demolimi i derës egzistuese me dim. 2.9x2.9m në hyrje të shkollës, furnizimi dhe vendosja e derës së re nga profili i Aluminit, dera të jete dy kriheshe sipas asaj egzistuese, në llogari të parashihet edhe rregullimi i shpaletave.	Cope	1	500.00 €	500.00 €
16	Demolimi dhe rivendosja e vertikales së demtuar të kanalizimit ø160, në llogari të parashihet edhe mveshja me knauf dhe suvatimi, vendosja e dy revizorve dhe lidhja e dy kyqjeve.	m	15	6.00 €	90.00 €
Totali me të gjitha ngarkesat					3,808.70 €